

Viça të përgatitur mirë për stinën e ftohtë të dimrit

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioner i AUSTRIA Prämix shpk.



Në fabrikat e përpunimit të qumështit, sëmundjet dhe humbjet e viçave ndikojnë negativisht në ekonominë e tyre. Kostot e larta për medikamente, kontrollet mjekësore dhe shpenzimet për përkujdesje çojnë në humbje të konsiderueshme financiare.


Edhe pse shkalla e sëmundshmërisë në muajt e ftohtë dhe të lagësht të dimrit rritet, kjo nuk do të thotë se është shkaku i vetëm i sëmundjes së viçave. Sëmundjet tipike sezonale janë ato të frymëmarrjes, sidomos gripi i gjedhit. Gripi është një faktor dytësor dhe prek më së shumti viçat e dobët dhe të prekur nga diarreja e hershme.

Shëndeti i mirë i zorrëve

Shëndeti i mirë i zorrëve është konsideruar si një themel i rëndësishëm për rritjen e suksesshme të viçave. Produkte me faktorin SSR (siguri/ shëndet/ rritje), të programit për viçat të Schaumann, mbështesin shëndetin e aparatit tretës. Schaumann ofron një gamë të gjerë produktesh si zëvendësues të qumështit, komponentë dhe produkte speciale të cilat kanë si synim përmirësimin e shëndetit të zorrëve që në fazat më të hershme të jetës. Gripi i gjedhit

shpesh herë shfaqet në moshën nga 4 deri në 8 javë. Në këtë periudhë viçat përballen me „Sistem imunitar të ulët“ (Fig. 1) e cila bëhet më e dukshme nëse janë bërë gabime në fazën e të ushqyerit me kulloshtër.

Furnizimi me kulloshtër me sasinë, cilësinë dhe kohën e duhur, është themeli bazë për rezistencën e viçit. Kulloshtera me një cilësi të mirë, përftohet vetëm nga lopët të cilat gjatë periudhës së tharjes janë ushqyer në mënyrë optimale. Përmbajtja e imunglobulinës në kulloshtër dhe furnizimi i menjëhershëm pas lindjes me vitamin A, përmirësohet ndjeshëm me përdorimin e produktit **Kalbi Vital und Kalbi Farm.**



Pas fazës së ushqyerjes me kulloshtër, pasurimi i pijeve në ditët e para me imunglobulin me veprim lokal, mund të sigurohet nëpërmjet produktit **Kalbi-Start Super.** Gjithashtu mund të zëvendësohet me një zëvendësues qumështi si **Kalbi Milch Plus Protect,** me përmbajtje të probiotikut Provita LE.

Plotësimi me energji

Gjatë ushqyerjes së viçave në stinën e dimrit shpesh herë anashkalohe fakti se temperaturat e ulta rrisin kërkesën për energji. Nevoja për rregullimin e temperaturës mund të shkojë deri në 35%. Zëvendësuesit e qumështit si **Kalbi Milch Classic** ose **Kalbi Milch Plus Protect** janë vetëm dy nga mundësitë e shumta që ofrohen për të përmbushur kërkesat në këtë situatë. Një rritje e sasisë nga 125g zëvendësues qumështi/litër në 150 g/litër ose ushqime të lëngshme shtesë, mund të mbulojë nevojat shtesë të viçit.

Zëvendësuesit e qumështit me faktorin SSR përmbajnë kombinime të substancave aktive, të cilat mbështesin veçanërisht shëndetin e zorrëve. Probiotiku Provita LE, komponent me

përmbajtje fibrash speciale dhe acide yndyrore speciale, janë kombinime të testuara prej vitesh.

T'i kushtohet vëmendje klimës në stallë

Përveç motit të ftohtë, viçat përballen me kushte të tjera të këqija si shpejtësi e lartë e ajrit me nivele të larta të lagështisë. Situatën e përkeqësojnë korentet e ajrit te gabuara në stalla me ventilim të gabuar ose mbyllja e të gjitha dymve dhe dritareve, rritja e nivelit të gazrave të dëmshme dhe lagështia e ajrit.

Mikrobet patogjene gjejnë kushte të përshtatshme për të dëmtuar viçat e pambrojtur. Gjatë stinës së dimrit duhet të merren masa të veçanta për procesin e rritjes. Ruajtja e ambientit të thatë, të pastër, ruajtja nga korentet e ajrit, janë disa nga pikat kyçe që duhet t'i kushtohet vëmendje në këtë periudhë delikate për viçin.

Këto janë vetëm disa nga sfidat që përballen fermerët në stinën e dimrit dhe që mund të kompensohen nga viçat e shëndetshëm deri në një grad të caktuar. Produktet e Schaumann ndikojnë pozitivisht në shmangien e diarresë në viçat e vegjël dhe ndihmojnë fermerin të rrisë viça të shëndetshëm.